



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1804/8 prot.

Datë 01.11.2021

V E N D I M

Nr. 828/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.11.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-94383-04-30-2021, me objekt “*Prodhimi i Emisioneve të Pullës për vitin 2021*” me fond limit 11,405,250 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 07.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Kristalina KH” SHPK.
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

“Albdesign PSP” SHPK.
Adresa: Rruga “Çerçiz Topulli”, Kashar Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Posta Shqiptare SHA
Adesa: Rruga "Reshit Çollaku", Nr. 4 Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Vendimii Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.04.2021 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit "Procedurë e Hapur" me Nr. REF-94383-04-30-2021, me objekt "Prodhimi i Emisioneve të Pullës për vitin 2021" me fond limit 11,405,250 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 07.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare.

II.2. Në datën 07.07.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 14.09.2021 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- Kristalina KH	9,320,500	I skualifikuar
- Albdesign PSP	9,442,250	I skualifikuar
- Adel Co	10,928,250	I kualifikuar
- Dynamicx Group	7.947.750	I skualifikuar

II.4. Në datën 14.09.2021 operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “Kristalina.KH” sh.p.k. me NUIS K11501002D

- a) Në kriterin 2.3.11 kërkohet “Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakteristikave si më poshtë: ♣ Pesha totale e letrës me gjithë elementët e saj përfshirë ngjitësin, fijet fosforeshente dhe llakun të jetë minimumi 95 gr/m² deri në 105 gr/m² maksimumi. ♣ Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi. ♣ Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV.

Për përmbushjen e kriterit si më sipër, Operatori ekonomik ka paraqitur dy mostra:

1. letrën e pullës CP ST 543, e cila nga testimet përkatëse rezultoi se

a) pesha totale e letrës është: 92.259 gr/m²

b) bardhësia 78 %, ndërkohë që në kriteret kualifikuese kërkohet që bardhësia e letrët të jetë minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi.

c) fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndricimin e llampës UV

2. letrën e pullës ST 114, e cila nga testimet përkatëse rezultoi se:

a) pesha totale e letrës është: 101.223 gr/m²

b) bardhësia 87 %,

c) fijet fosforeshente të së cilës janë të dukshme me sy të lirë, në kundërshtim me kriterin e sipërciatuar.

- b) Në përmbushje të kriterit të kualifikimit 2.3.5., ku përcaktohet se “Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 9001 për cilësinë e prodhimit të mallrave me elementë sigurie ose ekuivalente. (Certifikata duhet të jete e leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë)” si dhe të kriterit 2.3.6 ku përcaktohet se: “Operatori

Ekonomik të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 14298 për menaxhimin e sigurisë së procesit të shtypit të prodhimit të mallrave me elementë sigurie ose ekuivalente. (Certifikata duhet të jete e leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë), Operatori “Kristalina.KH” sh.p.k ka paraqitur: a) Certifikatën e Cilësisë ISO 9001:2015 me objekt veprimtarie: “Shtypshkrime dhe shërbimi i stampimit të materialeve publicitare, editoriale, pullave, etiketave etj në këtë fushë” duke mos përfshirë prodhimin e mallrave me elementë sigurie, sikurse kërkohet në kriteret e kualifikimit. b) Certifikatën e Cilësisë ISO 14298:2013 me objekt veprimtarie: “Shtypshkrime dhe shërbimi i stampimit të materialeve publicitare, editoriale, pullave, etiketave etj në këtë fushë” duke mos përfshirë prodhimin e mallrave me elementë sigurie, sikurse kërkohet në kriteret e kualifikimit. Sa më sipër, operatori ekonomik “Kristalina.KH” sh.p.k, nuk i përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuar në dokumentat e tenderit, për rrjedhojë oferta e tij nuk kualifikohet.

II.5. Në datën 22.09.2021 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 27.09.2021, operatori ekonomik ankimes “Kristalina-KH” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij me argumentet si më poshtë:

- *Shoqëria jonë ka dorëzuar mostra me dy lloje të letrave nga kompania lider në prodhimin e letrës së pullës, Tullis Rusell dhe konkretisht janë dorëzuar mostra sic kërkohen nga AK të shoqëruar me skedën teknike si dhe një deklaratë për dorëzim mostrash dhe skedave teknike më datë 07.07.2021 për procedurën në fjalë. Në këtë deklaratë janë specifikuar dy llojet e letrave dhe skedave teknike. Kjo deklaratë është në vazhdimësi të kërkesës që ne paraprkisht i kemi paraqitur kompanisë Tullis Rusell për pajisjen e shoqërisë sonë me skedat teknike dhe kampionet e letrave të cilat janë dorëzuar dorazi dhe në mënyrë elektronike. Në këtë deklaratë ne deklaruar se përzgjedhja e letrës është në të drejtën e AK. Arsyeja se pse u paraqitëm me dy skeda teknike ishte sepse në vitin 2020 të tre konkurrentët u paraqitën me skedë teknike CPST 114 por pulla e vitit 2020 është prodhuar me letrën me skedë teknike CPST 543.*

Sic përcaktohet edhe në shkresat dhe emaillet të cilat i gjeni bashkëlidhur në të cilat kompania Tullis Rusell na informon dhe deklaron se prodhimi i pullës postare shqiptare që nga viti 2007 e deri më sot është prodhuar me letrën CPST 543. Bashkëngjitur gjeni emaillet dhe skedën teknike.

Jemi të habitur nga fakti se si KVO ka realizuar matjen e gramaturës dhe bardhësisë për Kristalina-KH kur në dy vendime të KPP konkretisht vendimet nr.550/2021 dhe 551/2021 rezulton se nuk ka në Shqipëri asnjë laborator të akredituar momentalisht

për kryerjen e testeve të letrës ku laboratorit pranë UPT i ka mbaruar akreditimi në qershor të vitit 2020. Të njëjtat aparatura po ti kishte përdorur edhe për Adel Co do të kishim të njëjtin rezultat.

Kërkojmë nga KSHA dhe KPP të verifikohen treguesit e skedës teknike të paraqitur nga Adel Co dhe të bëhet verifikimi nëse në skedën teknike të Tullis Russel janë bërë ndërhyrje përpara përkthimit dhe noterizimit dhe të verifikohet nëse përputhet me skedën teknike që Tullis Russell jep për të gjithë. Vëmë re se për skedën teknike CPST 543 pesha e letrës sipas KVO është 92.259 gr/m² dhe bardhësia 78% ndërkohë që nuk flet fare për fijen fosforeshente të vendosura me shtyp nga ana jonë sipas deklaratës për dorëzimin e mostrave të datës 07.07.2021 të ngarkuar në SPE dhe dorëzuar fizikisht në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Të dy llojet e letrave të përdorura për prodhimin e mostrave nga shoqëria jonë konkretisht letra CPST 114 dhe letra CPST 543 janë letra të cilat i plotësojnë kriteret e vendosura për prodhimin e pullës dhe ndryshimi qëndron në faktin se në letrën CPST 543 fijen fosforeshente janë të vendosura me shtyp.

- *Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit: kompania Kristalina KH shpk është e certifikuar nga organizimi Certi E sipas standarteve: ISO 9001:2015; 14001:2015; PASS 99:2012; 27001:2013;14298:2013 ndër të tjera për prodhimin e etiketave dhe pullave. Në kuadrin e auditeve të kryera konfirmojmë se nga dokumentacioni i verifikuar këto janë prodhime me elementë sigurie. Certifikatat e mësipërme janë të vlefshme. Në të dyja ISOT e kërkuara 9001:2015 dhe 14298:2013 është e shkruajtur qartë fjalia Pullave dhe KVO nuk e ka parë. Shoqëria jonë është certifikuar sipas objektit të ushtrimit të aktivitetit të përcaktuar në Ekstraktin Historik të shoqërisë sonë nga QKB prandaj ISOT e paraqitura nga ana jonë përfshijnë të gjithë aktivitetin prodhues dhe në rastin konkret e përfshijnë edhe prodhimin e pullës. Sa më sipër arsyeja e dytë e skualifikimit nuk qëndron.*
- *Kërkojmë që për pretendimet e AK se letra e pullës për të cilën ne kemi paraqitur 2 mostra buk plotëson specifikimet teknike të kërkuesit në DT të analizohen nga një/disa ekspertë ose laborator i specializuar për të bërë analizat e treguesve kimikë, peshës përmbajtjes së fijeve fosforeshente etj të përcaktuara në specifikimet teknike në bashkëpunim me kompaninë Tullis Rusell.*
- *Përfundimisht kërkojmë”*
- *Ti kërkohet informacion kompanisë Tullis Rusell për të vërtetuar mostrat dhe skedat teknike për të gjitha kompanitë pjesëmarrëse në këtë prokurim.*
- *Kualifikimin e shoqërisë Kristalina KH shpk*
- *Kontrollin e skedave teknike dhe mostrave të paraqitura nga kompania Adel Co e cila është kualifikuar dhe të bëhet krahasimi i skedave teknike dhe letrave të përdorura për prodhimin e mostrave të paraqitura për këtë procedurë nga të gjithë OE pjesëmarrës.*

II.7. Me shkresën nr. 938/28 prot, datë 05.10.2021 me objekt: “Informacion”, protokolluar me tonën me nr. 1804/5 prot datë 06.10.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori

ekonomik “Kristalina-KH” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.8. Në datën 14.09.2021 operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

a) Në përmbushje të kriterit të kualifikimit 2.3.11 ku kërkohet që ”Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakteristikave si më poshtë:c)Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV... » .

Operatori ekonomik ka paraqitur letrën e pullës, fijet fosforeshente të së cilës janë të dukshme me sy të lirë, në kundërshtim me kriterin e sipërciutuar.

b) Në përmbushje të kriterit të kualifikimit 2.3.8., ku përcaktohet që: “Operatori Ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinimin e letrës dhe për produktet e gatshme të siguruara me kamera sigurie. Për këtë duhet të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë shitblerje ose kontratë dhurimi ose kontratë qiraje të ambientit, shoqëruar me dokumentacion pronësie të qiradhenësit.”, operatori ekonomik ka paraqitur Kontratë Qeraje nr. 3931 Rep/923Kol, datë 08.09.2016, me palë Qiradhënës shoqëria “ALBDESIGN” sh.p.k. dhe Qiramarrës shoqëria “ALBDESIGN PSP” sh.p.k., me objekt “Dhënie me qira e një ambjenti”, me afat deri më datë 31 Korrik 2021. Kontrata është nënshkruar para noteres Nikoleta P. Gjordeni. Bashkëlidhur kontratës ndodhet: ♣ Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar i shoqërisë ALBDESIGN PSP, Certifikata e regjistrimit, Planimetria e katit përdhe; ♣ Kontratë Qiraje nr. 3929 Rep/921Kol, nënshkruar para noteres Nikoleta P. Gjordeni, midis palëve Qiradhënës Gentjan Sula dhe Qiramarrës shoqëria ALBDESIGN sh.p.k., me objekt dhënie me qira e mjediseve tregtare “Kapanon Industrial 2 kat” Pasuria nr. 17/36, ZK 2679, Volumi 16, Faqe 143, me sipërfaqe trualli 2130 m2, nga e cila ndërtesë 895.3 m2, me afat deri më datë 31 Korrik 2021. ♣ Certifikata për vërtetim pronësie, në emër të Gentjan Astrit Sulo, shoqëruar me Hartën treguese dhe Kartelën e regjistrimit; ♣ Deklaratë Noteriale nr. Repertori 3106/koleksioni 989, datë 06.07.2021, para noteres Nikoleta P. Gjordeni, e mbajtur nga palët deklaruese “ALBDESIGN” sh.p.k. dhe “ALBDESIGN PSP” sh.p.k., të cilët deklarojnë se : “Sot ditën e nënshkrimit të kësaj deklarate noteriale ne rikonfirmojmë vullnetin tonë për vazhdimin e afatit të kësaj kontrate qeraje edhe për një 5 (pesë) vjeçar tjetër, me të njëjta kushte me kontratën me nr. 39321 rep., 923kol, datë 08.09.2016, notere Nikoleta Gjordeni”. Mbështetur në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 821 “Përsëritja e kontratës së qirasë”, ku është parashikuar që: “Qiraja e re rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmeja, por kohëzgjatja e saj caktohet si për qiratë me afat të caktuar”, zgjatja e afatit të qirasë nga palët duhej të ishte bërë me amendim të kontratës së qirasë dhe jo deklaratë, pasi objekti i kontratës së qiradhenies është pasuri e paluajtshme. Gjithashtu kontrata e qirasë midis pronarit

të pasurisë sëpaluajtshme Gentjan Sula dhe ALBDESIGN sh.p.k. (kjo e fundit ka dhënë me nënkontraktim pasurinë shoqërisë ALBDESIGN PSP sh.p.k.) është me afat deri më 31 Korrik 2021, duke e bërë të pavlefshëm zgjatjen e afatit të qiradhënies edhe për një 5 vjeçar tjetër, midis palëve ALBDESIGN sh.p.k. dhe ALBDESIGN PSP sh.p.k., në kushtet kur nuk është paraqitur një dokument ligjor që tëfaktojët drejtën e shoqërisë ALBDESIGN sh.p.k. për shtyrjen e afatit të kontratës. Sa më sipër, operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k., nuk i përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuar në dokumentat e tenderit , për rrjedhojë oferta e tij nuk kualifikohet.

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 27.09.2021, operatori ekonomik ankimes “Albdesign PSP” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij me pretendimet si më poshtë:

- Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit vlerësojmë se kërkesa për dorëzimin e një mostre e cila ndër të tjera të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndricimin e llampës UV, është një kërkesë e përmbushur nga shoqëria jonë pasi sample i dorëzuar nga shoqëria jonë i plotëson specifikimet dhe përmban të gjitha elementët e parashikuar në DT. Sa më sipër vlerësojmë se skualifikimi i shoqërisë sonë me arsyetimin se **fijet fosforeshente janë të dukshme me sy të lirë**, është tërësisht i pabazuar në fakt dhe si i tillë nuk qëndron. Për këtë arsye kërkojmë të kryhet verifikimi i mostrës së dorëzuar nga shoqëria jonë në mënyrë të tillë që bazuar në specifikimet teknike të parashikuara në DT të konstatohet përmbushja e këtij kriteri nga shoqëria jonë.
- Së dyti lidhur me arsyen tjetër të skualifikimit sqarojmë, se shoqëria jonë ka marrë me qera ambjentin në një nga format e parashikuara në nenin 801 të Kodit Civil të RSH. Nëpërmjet kontratës së qerasë dhe nëpërmjet deklaratës noteriale palët kanë shprehur vullnetin e tyre thjesht për zgjatjen e afatit të kontratës së qerases ekzistuese duke e bërë këtë deklaratë pjesë përbërëse të kontratës ekzistuese dhe duke ja bashkëngjitur asaj.
- Gjithashtu sqarojmë se kontrata e qerasë është rinovuar në mënyrë automatike me të njëjtat kushte dhe do të vazhdojë të jetë aktive deri në momentin kur njëra palë e prish atë në mënyrë të njëanshme për të cilën duhet të njotojë me shkrim palën tjetër në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në kontratën e qerasë.
- Sa më sipër vlerësojmë se pretendimi i AK nuk është i bazuar në ligj dhe në fakt dhe për këtë arsye nuk qëndron.
- Gjithashtu në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Adel Co shpk vlerësojmë se nuk duhet të ishte kualifikuar pasi kemi dyshime të arsyeshme se administratori i këtij OE ka qenë i dënuar dhe për këtë arsye kërkojmë kryerjen e verifikimeve të nevojshme në bashkëpunim me MD për të verifikuar vërtetësinë e Deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të dorëzuar nga Adel Co shpk.

II.10. Me shkresën nr. 938/26 prot, datë 05.10.2021 me objekt: “Shqyrtim ankesë”, protokolluar me tonën me nr. 1806/3 prot datë 06.10.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesave, i publikoi ato në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularët e publikimit nr.1804/2 prot 28.09.2021 dhe nr.1806/2 datë 28.09.2021, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Kristalina-KH SHPK dhe “Albdesign PSP” shpk, për të cilat ngrihen pretendimet si dhe kriteret të cilat pretendohet se nuk përmbushen nga operatori ekonomik Adel Co shpk.

II.12. Me shkresën nr. 938/29 prot, datë 19.10.2021 me objekt: “Informacion”, protokolluar me tonën me nr. 1804/7 prot datë 20.10.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni për procedurën e mësipërme të prokurimit objekt-ankimi.

II.13. Komisioni i Prokurimit Publik me shkresat Nr.1804/6 prot datë 19.10.2021 dhe nr.1806/5 datë 19.10.2021 me lëndë seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, njoftoi palët në proces lidhur me mbajtjen e një seance dëgjimore për çështjen objekt-shqyrtimi në datën 21.10.2021 ora 09:00 dhe 09:30.

II.14. Në datën 21.10.2021 ora 09:00 u mbajt seanca dëgjimore me përfaqësuesin e operatorit ekonomik Kristalina KH SHPK, posta shqiptare në mungesë. Ndërsa në orën 09:30 u mbajt seanca dëgjimore me përfaqësues të autoritetit kontraktor posta shqiptare SHA, operatori ekonomik Albdesign PSP në mungesë. Në këto seanca dëgjimore u mbajtën procesverbalët përkatëse pjesë e dosjeve objekt-shqyrtimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kristalina-KH” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: *Operatori ekonomik “Kristalina.KH” sh.p.k. me NUIS K11501002D Në kriterin 2.3.11 kërkohet “Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre*

pullë sipas specifikimeve/karakretistikave si më poshtë: ♣ Pësha totale e letrës me gjithë elementët e saj përfshirë ngjitësin, fijet fosforeshente dhe llakun të jetë minimumi 95 gr/m² deri në 105 gr/m² maksimumi. ♣ Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi. ♣ Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV.

Për përmbushjen e kriterit si më sipër, Operatori ekonomik ka paraqitur dy mostra:

1. letrën e pullës CPST 543, e cila nga testimet përkatëse rezultoi se

a) pësha totale e letrës është: 92.259 gr/m²

b) bardhësia 78 %, ndërkohë që në kriteret kualifikuese kërkohet që bardhësia e letrës të jetë minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi.

c) fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV

2. letrën e pullës ST 114, e cila nga testimet përkatëse rezultoi se:

a) pësha totale e letrës është: 101.223 gr/m²

b) bardhësia 87 %,

c) fijet fosforeshente të së cilës janë të dukshme me sy të lirë, në kundërshtim me kriterin e sipërciutuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3/11 “Kapaciteti teknik të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.11. *Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pullë sipas specifikimeve/karakretistikave si më poshtë:*

a) Pësha totale e letrës me gjithë elementët e saj përfshirë ngjitësin, fijet fosforeshente dhe llakun të jetë minimumi 95 gr/m² deri në 105 gr/m² maksimumi.

b) Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi.

c) Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV.

d) Letra e pullës postare të ketë bashkëngjitur skedën teknike të saj nga kompania prodhuese e letrës.

e) Kampioni të jetë në përmasa jo më të vogël së formati A3.

III.1.2. Në seksionin 2 “Objekti i Kontratës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka):

Ose: nga *në*

2.14 Do të pranohen variantet:

Po *Jo*

III.1.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.6. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.7. Në nenin 40 pika 1 dhe 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në*

përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. Nëpërmjet shkresës nr.938/29 datë 19.10.2021 protokolluar me tonën me nr.1804/7 datë 20.10.2021 me objekt “*Dërgohet informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, së bashku me mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues.

III.1.9. Gjithashtu nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik Kristalina KH SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë për dorëzim mostrash dhe skedave teknike
- Shtypshkronja Kristalina KH SHPK dorëzon me anë të kësaj deklaratë skedën teknike të letrës së pullës postare në formë elektronike dhe dorazi së bashku me mostrat e mëposhtme:
- Skedën teknike të letrës së pullës postare me nr.CPST 543
- Kampion letër pulle jo më e vogël se A3 me letër pulle postare me nr.CPST 543
- Kampion tabak letre pulle postare në formatin A3 të birosur me letër pulle postare me nr.CPST 543
- Kampion letër pulle postare të bllokut 1/a format 80x60 mm (në brendësi i birosur 40x30 mm) me letër pulle postare me nr.CPST 543.

- Skedën teknike të letrës së pullës postare me letër pulle postare me nr.CPST 114
- Kampion letër pulle jo më e vogël se A3 me letër pulle postare me nr.CPST 114
- Kampion tabak letre pulle postare në formatin A3 të biosur me letër pulle postare me nr. CPST 114
- Kampion letër pulle postare të bllokut 1/a format 80x60 mm (në brendësi i biosur 40x30 mm) me letër pulle postare me nr.CPST 114.
- Për të treguar interesin tonë ndaj këtij prokurimi kemi përgatitur modelet e kërkuara nga ju me të dy llojet e letrave, letrën me fije fosforeshente në brumin e letrës CPST 114 dhe letrën me fije fosforeshente të shtuara me shtyp CPST 543, letër e përdorur çdo vit për prodhimin e pullës. Diferenca është lehtësisht e provueshme, pasi letra me fije të shtypura i ka fijet të dukshme nën dritën UV, vetëm në anën e shtypur, në ndryshim nga letra që i ka në brum që janë të dukshme në të dy anët. Ne si kompani me eksperiencë mbi 20 vjeçare në treg, duke shprehur interesin për procedurën e publikuar nga ju, ofertojmë duke ju paraqitur dy lloje letrash, që i plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara nga ju. Për sa më sipër ju takon ju si autoritet kontraktor të përzgjidhni mostrën më të mirë për realizimin me sukses të objektit të kontratës që po prokuroni.

III.1.10. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin në datën dhe orën e hapjes së ofertave **një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakteristikave:** Pështa totale e letrës me gjithë elementet e saj përfshirë ngjitësin, fijet fosforeshente dhe llakun, të jetë minimumi 95 gr/m² deri në 105 gr/m² maksimumi ; Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi ; Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV ; Letra e pullës postare të ketë bashkëngjitur skedën teknike të saj nga kompania prodhuese e letrës; Kampioni të jetë në përmasa jo më të vogla se formati A3.

III.1.11.Sikundër pasqyruar më lart, KPP me qëllim gjykimin e çështjes, në mënyrë transparente ftoi palët në një seancë dëgjimore, me qëllim verifikimin e pretendimeve të palëve ankimese dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, e konkretisht seanca dëgjimore u fokusua në verifikimin e arsyes së skualifikimit lidhur me mospërmbushjen e kriterit, sa i takon letrës së pullës të ketë fijet fosforeshente vetëm nën ndriçimin e llambës ultraviolet. Në seancën dëgjimore mori pjesë operatori ekonomik Kristalina KH SHPK, ndërsa autoriteti kontraktor Posta Shqiptare nuk u paraqit në orën e caktuar për zhvillimin e seancës dëgjimore.

Në seancë, Komisioni iu drejtua palës ankimese me pyetje, nëse kishte pretendime në lidhje me arsyen e skualifikimit dhe për faktin se letra e pullës së paraqitur nga ana e tij ka fije fosforeshente që duken me sy të lire. Ankimesi sqaroi se: Në procedurën e prokurimit objekt-ankimi kemi paraqitur dy modele të letrës së pullës dhe dy skeda teknike nga prodhues të ndryshëm. Njëra nga modelet është CPST 114 dhe tjetra është CPST543. Kjo e fundit është letër, që janë vendosur elementet sekrete me shtyp dhe është letra që është përdorur për prodhimin e pullës nga 2007 e deri më sot. Letra CPST 114 ka tre elemente

sekrete, që duken me sy të lirë, por pasi bëhet shtypi zhduken këto elemente dhe ngelen vetëm elementet që shihen me llambën UV. Sipas meje te dyja modelet kanë permbushur specifikimet teknike dhe zgjedhjen perfundmtare ta jepte autoriteti kontraktor. Në ditën e dorëzimit të mostrave, të tre OE kanë paraqitur te njejten skede teknike dhe te njejten leter CPS114.

Gjithashtu ankimuesit iu shtrua pyetja, lidhur me faktin se sa modele jane kerkuar nga AK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. **A jane pranuar alternativat? Përgjigjja e ankimuesit ishte, se nuk është në dijeni.**

KPP sqaron, se në seancën dëgjimore u paraqit nga ana e ankimuesit llamba ultraviolet. Nga komisioni u krye verifikimi i mostres së operatorit ekonomik Kristalina KH SHPK me llambën ultraviolet, nga ku rezultoi se në mostrën me kod CPST 114 krahas elementeve te sigurisë, qe shihen me sy te lire, shihen edhe elemente të tjera sigurie. Ndërsa sa i takon mostrës me kod CPST543, elementet e sigurisë shihen vetëm nën ndriçimin e llambës ultraviolet.

III.1.12. Referuar sa më sipër, KPP pas verifikimit të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues, konstatoi se ky i fundit në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, ka paraqitur në cilësinë e mostrës dy modele me specifikime dhe karakteristika të ndryshme. KPP gjykon se fakti i dorëzimit në cilësinë e mostrave të dy modeleve, që sikundër pranuar nga ankimuesi janë prodhuar në mënyra të ndryshme, paraqet vështirësi jo vetëm në punën e KVO-së për përmbushjen e detyrimit ligjor nga ana e tyre të vlerësimit të pjesmarrësve në procedurë në pozita transparente dhe barazie, për shkak të përcaktimit në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi të mospranimit të varjanteve, por edhe të Komisionit të Prokurimit Publik duke shkaktuar konfuzion lidhur me mostrën, që duhet të vlerësojë në rastin konkret për efekt të përmbushjes së kriterit të veçantë të kualifikimit. KPP thekson, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se nuk do të pranohen variantet. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik ka pasur detyrimin të dorëzojë në cilësinë e mostrës vetëm një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakteristikave të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në kuptim dhe në zbatim të parimit të barazisë në trajtimin e kandidatëve/ofertuesve, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit tregon kujdes që të ngarkojë të njëjtat të drejta dhe detyrime në radhët e pjesmarrësve. Në rastin konkret, KPP gjykon, se në kushtet kur kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e një modeli mostre ka qenë qartësisht e hartuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, duke përjashtuar çdolloj forme të varianteve të tjera, ankimuesi duhet të kishte paraqitur një model mostre në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara. KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, ndërsa ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik, që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar, nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të prodhuar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Në rastin konkret ankimesi nuk provon, se ka paraqitur në cilësinë e mostrës një model në përputhje me kriter dhe specifikimet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.13. Gjithashtu KPP sqaron, se në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor, për sa i përket dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike etj., publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së i cili paashikon se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.*

2. *Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

3. *Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik Kristalina-KH SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Albdesign PSP SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: *Në përmbushje të kriterit të kualifikimit 2.3.11 ku kërkohet që: "Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakretistikave si më poshtë:c) Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llambës UV... » . Operatori ekonomik ka paraqitur letrën e pullës, fijet fosforeshente të së cilës janë të dukshme me sy të lirë, në kundërshtim me kriterin e sipërciatuar*, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3/11 "Kapaciteti teknik të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.11. *Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakretistikave si më poshtë:*

- f) *Pesha totale e letrës me gjithë elementët e saj përfshirë ngjitësin, fijet fosforeshente dhe llakun të jetë minimumi 95 gr/m² deri në 105 gr/m² maksimumi.*
- g) *Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi.*
- h) *Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV.*
- i) *Letra e pullës postare të ketë bashkëngjitur skedën teknike të saj nga kompania prodhuese e letrës.*
- j) *Kampioni të jetë në përmasa jo më të vogël së formati A3.*

III.2.2. Në seksionin 2 "Objekti i Kontratës" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka):

Ose: nga në

2.14 Do të pranohen variantet:

Po Jo

III.2.3. Neni 2 "Qëllimi i ligjit" 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit*

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.7. Në nenin 40 pika 1 dhe 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.
7. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- b) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.2.8. Nëpërmjet shkresës nr.938/29 datë 19.10.2021 protokolluar me tonën me nr.1804/7 datë 20.10.2021 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, së bashku me mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik ankimes.

III.2.9. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin në datën dhe orën e hapjes së ofertave një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakteristikave: Pështja totale e letrës me gjitha elementet e saj përfshirë ngjitësin, fijet fosforeshente dhe llakun të jetë minimumi 95 gr/m² deri në 105 gr/m² maksimumi ; Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi ; Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llambës UV ; Letra e pullës postare të ketë bashkëngjitur skedën teknike të saj nga kompania prodhuese e letrës ; Kampioni të jetë në përmasa jo më të vogla se formati A3.

III.2.10. Sikundër pasqyruar më lart, KPP me qëllim gjykimin e çështjes në mënyrë transparente ftoi palët në një seancë dëgjimore, me qëllim verifikimin e pretendimeve të palëve ankimese dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, e konkretisht lidhur me arsyen e skualifikimit sa i takon mospërmbushjes së kriterit për letrën e pullës, të ketë fijet fosforeshente vetëm nën ndriçimin e llambës ultraviolet. Në seancën dëgjimore mori pjesë autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA, ndërsa operatori ekonomik Albdesign PSP SHPK nuk u paraqit në orën e caktuar për zhvillimin e seancës dëgjimore.

III.2.11. Në seancën dëgjimore autoriteti kontraktori paraqiti edhe llambën ultraviolet për verifikimin e mostrës së paraqitur nga operatori ekonomik Albdesign PSP në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Komisioni verifikoi mostren e paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” me llambën ultraviolet, nga ku rezultoi, se përveç elementeve të sigurisë që

shihen me sy të lirë ka edhe elementë të tjere sigurie, që shihen me llambën ultraviolet. Në këto kushte KPP gjykon, se me të drejtë autoriteti kontraktor e ka konsideruar jo të rregullt mostrën e paraqitur nga ankimuesi, pasi është jo konform specifikimeve teknike. Mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të prodhuar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Në rastin konkret mostra e letrës e dorëzuar nga ankimuesi nuk përmbush të gjitha specifikimet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

III.2.12. Sqarojmë se, në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor për sa i përket dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike etj., publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së i cili paashikon se *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.*

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në

dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik Albdesign PSP SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorëve ekonomikë ankimues mbi arsyet e tjera të skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjyqimit mësipër gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e ankimuesve do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Kristalina-KH SHPK për *Kontrollin e skedave teknike dhe mostrave të paraqitura nga kompania Adel Co e cila është kualifikuar dhe të bëhet krahasimi i skedave teknike dhe letrave të përdorura për prodhimin e mostrave të paraqitura për këtë procedurë nga të gjithë OE pjesëmarrës”, KPP sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 94 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Dispozita e sipërpërmendur kërkon që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Kristalina-KH SHPK nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010

“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-94383-04-30-2021, me objekt “*Prodhimi i Emisioneve të Pullës për vitin 2021*” me fond limit 11,405,250 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 07.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare.
 2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
 3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK dhe “Albdesign PSP” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri